



# Bisedë përmes përkthyesit

Një udhëzim i shkurtë



ALBANSK



---

Integrerings- og mangfoldsdirektoratet

Kur dy palë kanë nevojë të komunikojnë me njëri tjetrin por nuk kanë gjuhë të përbashkët, përkthyesi është hallka e domosdoshme që e mundëson bisedën në mes tyre. Qëllimi i bisedës së përkthyer është që t'i ngjajë sa më tepër një bisede normale. Megjithatë, është e qartë që duhet të mirren disa masa kur biseda bëhet me ndërmjetësimin e përkthyesit.

Kjo broshurë jep një njoftim të shkurtë të funksionit të përkthyesit në bisedë dhe të rolit që ai luan për Ju që do të flitni përmes përkthyesit. Në fund, broshura tregon edhe disa rrethana që duhet të keni të qarta kur bisedoni përmes përkthyesit.

## Funksioni i përkthyesit

përcaktohet nga rregullat etike profesionale të përkthyesit. Rregullat etike kryesore të përkthyesit gjatë punës së tij janë:

- Përkthyesi duhet të përkthejë çdo gjë që thuhet gjatë bisedës, nuk duhet të heshtë kurrgjë, nuk duhet të ndryshojë kurrgjë dhe nuk duhet të shtojë kurrgjë.
- Përkthyesi duhet të jetë i paanshëm gjatë përkthimit, dhe qëndrimet e veta nuk duhet të ndikojnë në përkthimin.
- Përkthyesi nuk mund të marrë përsipër detyra tjera në lidhje me përkthimin.
- Përkthyesi ka detyrën absolute të mbajtjes së sekretit-profesional

### Detyra absolute e mbajtjes së sekretit profesional do të thotë që

- detyra e mbajtjes së sekretit profesional përfshin gjithë informatat që përkthyesi merr në lidhje me përkthimin
- detyra e mbajtjes së sekretit vlen përballë "çdo njeriut", edhe përballë eprrorëve, kolegëve dhe families
- detyra e mbajtjes së sekretit është në fuqi edhe pasi përkthyesi e ka mbaruar shërbimin si përkthyes

### Për Ju që përdorni përkthyes kjo do të thotë që:

- jeni vetë përgjegjës për çdo gjë që shprehni gjatë bisedës
- përkthyesi nuk është përgjegjës për të drejtën ose për të vërtetën e informatave që Ju dhe pala në bisedë i jepni njëri tjetrit
- përkthyesi *nuk* mund të mbajë në mend se çfarë i keni thënë njëri tjetrit, ai nuk është "kujtesa" Juaj
- përkthyesi *nuk* mund të jetë person i autorizuar i njerës palë ose tjetrës
- përkthyesi është i detyruar që të tregojë në qoftë se është në gjende jo-aftësie për përkthim në raste kur përkthyesi
  - është farefis, i/e martuar, i/e fejuar me një nga palët
  - kur ai/ajo vetë është palë në çështjen
  - ose kur ai/ajo ka vepruar në çështjen për një nga palët
- Përkthyesi duhet të tregojë në qoftë se ai/ajo nuk është në gjëndje që të kryejë detyrën në mënyrë të përshtatshme

# Gjëra të rëndësishme kur bisedoni përmes përkthyesit

Folni *me* partnerin e bisedës, dhe jo *mbi* atë

- drejtohuni partnerit dhe jo përkthyesit.  
D. m. th. mos thuani "pyetni a doni...", por thuani direkt: "a doni...". Përkthyesi do ta përkthejë në këtë mënyrë dhe biseda e përkthyme do t'i ngjajë më tepër një bisede normale.
- Në qoftë se diçka Ju duket e paqartë ose në qoftë se dyshoni se ç'ka kuptuar pala tjetër, duhet t'a pyetni atë – përkthyesi do t'a përkthejë pyetjen.

## Planifikoni se ç'doni të thoni

- i kushtoni rëndësi pikave kryesore.
- Folni shkurtimisht dhe jepni përkthyesit mundësi që të përkthejë. Kështu përkthimi do të jetë më i përpiktë dhe pala tjetër do të ketë mundësi të përgjigjet ose të bëjë komentare – si në një bisedë normale
- Shprehuni qartësisht dhe në mënyrë konkrete. Në qoftë se, p. sh. përdorni fjalë të urta, duhet të sqaroni njëkohësisht se ç'nënkuptoni.

## Duhet të dini edhe që

- **levizjet e fytyrës dhe të trupit** që zakonisht nënvizojnë fjalët e një bisede normale do të kenë efekt të pakësuar në një bisedë të përkthyer. Një bisedë me përkthyes i ngjan pak një bisede telefonike, gjatë së cilës kemi vetëm fjalët dhe zërin si ndihmë për të kuptuar përmbajtjen.
- **Disa gjeste** mund të kenë kuptime të ndryshme në gjuha të ndryshme (p. sh. lëkundja e kokës norvegjisht do të thotë "po", kurse në vende tjerë do të thotë "jo"). Rrethanat e këtilla duhet ti keni parasysh.
- **Përkthimi është një punë e vështirë.** Përkthyesi duhet të koncentrohet në tërësi në përkthimin dhe nuk mund të kryej detyra tjera përveç atyre gjuhësore. Përkthyesi lodhet më shpejt se palët e bisedës dhe do të ketë nevojë për pushim gjatë punës.

Denne brosjyren finnes også på følgende språk:  
norsk, arabisk, engelsk, fransk, kurdisk,  
russisk, serbokroatisk, somali, spansk, tamil,  
tyrkisk, urdu



Integrerings- og mangfoldsdirektoratet

#### IMDi Øst

Fylkene Østfold, Vestfold,  
Akershus og Oslo  
Postboks 8059 Dep  
0031 OSLO  
Telefon 24 16 88 00  
Telefaks 24 16 88 31

#### IMDi Indre Østland

Fylkene Hedmark,  
Oppland og Buskerud  
Postboks 1253,  
2806 GJØVIK  
Telefon 24 16 88 00  
Telefaks 61 17 08 95

#### IMDi Sør

Fylkene Telemark,  
Aust-Agder og Vest-Agder  
Postboks 647,

#### 4666 KRISTIANSAND

Telefon 24 16 88 00  
Telefaks 38 02 04 80

#### IMDi Vest

Fylkene Rogaland, Hordaland og Sogn og Fjordane  
Postboks 4048 Dreggen,  
5835 BERGEN  
Telefon 24 16 88 00  
Telefaks 55 30 09 88

#### IMDi Midt-Norge

Fylkene Møre og Romsdal,  
Sør- og Nord-Trøndelag  
IMDi Midt-Norge,  
7005 TRONDHEIM  
Telefon 24 16 88 00  
Telefaks 73 89 24 31

#### IMDi Nord

Fylkene Nordland,  
Troms og Finnmark  
Postboks 83,  
8502 NARVIK  
Telefon 24 16 88 00  
Telefax 76 96 58 38

#### Integrerings- og mangfoldsdirektoratet

Postboks 8059 Dep.  
N-0031 Oslo

Kontoradr.:  
Hausmannsgt 23  
Tlf: (+47) 24 16 88 00  
Faks: (+47) 24 16 88 01  
www.imdi.no  
E-post: imdi@imdi.no